VENDIM
Nr. 590, datë 10.9.2014

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS TE MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TË OBJEKTIT "ISH-KOMBINATI I TEKSTILEVE", BERAT, ME NUMËR PASURIE 19/59, NË ZONËN KADASTRALE 8501, DHE SIPËRFAQE 8 117 M², DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 226 , DATË 23.4.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të objektit "Ish-Kombinati i Tekstileve", Berat, me numër pasurie 19/59, në zonën kadastrale 8501, dhe sipërfaqe 8 117 (tetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) m².
2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave në administrim të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, miratuar me vendimin nr. 226, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave.
3. Vendimi nr. 1079, datë 10.12.2010, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e objektit "Ish-Kombinati i Tekstileve", Berat, me numër pasurie 19/95, në zonën kadastrale 8501, me sipërfaqe 8 117 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor"", shfuqizohet.
4. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama